

---

**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

**Data: \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025**

**PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**Objekti i procedurës: “Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës për QKUM”.**

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):**

34144000-8     Automjete për qëllime të veçanta  
34114121-3     Ambulanca

**Vlera e fondit limit: 143,956,280** (njëqind e dyzet e tre milion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë **pa TVSH**, ose 1,489,767.98 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 06.11.2025 është 96.63 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara** sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të kontratës**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar *jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të lotit* është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit*”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) [www.obp.al](http://www.obp.al)

## 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për autoambulancat. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që

kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

**3.** Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht një servis në pronësi/me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacion si më poshtë:

- Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licencat, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet;
- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje të vlefshme jo më pak se afati i garancisë/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës me nr.1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitetet teknike (servis) për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe riparimit të autoambulancave brenda periudhës së garancisë së dhënë nga prodhuesi ose distributori i autorizuar/ ofertuesi. Servisi/et duhet të jetë i pajisur me licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) me qëllim ushtrimin e ligjshëm të aktivitetit të tij. Ky kriter garanton AK-në se operatori ekonomik fitues zotëron kualifikimet e nevojshme teknike dhe profesionale për realizimin me sukses të kontratës.

**4.** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë

---

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) [www.obp.al](http://www.obp.al)

kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar për automjetin dhe paisjet mjekesore ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mallrat e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC).

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi. Duke qenë se mjetet janë kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, detyrimisht është kërkuar paraqitja e certifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu certifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë garancie, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 2 vite për autoambulancën dhe kabinën e pacientit:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin, gjatë periudhës së garancisë.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar.

Deklaratat shërbejnë si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi do të jetë në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues, si dhe garantohet kryerja e shërbimeve për riparimin e mjeteve, gjatë periudhës së garancisë.

**8.** Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të targuara dhe regjistruara në pronësi të autoritetit kontraktoror përfitues, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjetet do të dorezohen pranë AK të pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

**9.** Deklaratë ku të citohet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës se autoambulancat do të jenë të pajisura me të gjitha pajisjet dhe aparaturat mjekësore të kërkuara në shtojcën 6, në përputhje me standartet e cilësisë dhe specifikimeve teknike përkatëse.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar se operatorët ekonomik pjesëmarrës do të ofrojnë të gjithë mallin objekt prokurimi sipas standarteve të cilësisë dhe specifikimeve teknike përkatëse.

**10.** Deklaratë ku të citohet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës se kabina e pacientit të autoambulancave do të jetë në përputhje me standartet e cilësisë dhe specifikimeve teknike të kërkuara në shtojcën 6.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar se operatorët ekonomik pjesëmarrës do të ofrojnë mallin objekt prokurimi sipas standarteve të cilësisë dhe specifikimeve teknike përkatëse.

**11.** Duke qene se autoambulancat duhet te kenë garanci nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij 2 vjet, per pjesen motorrike, mekanike elektrike etj., OE, duhet te paraqesi nje preventiv te sherbimeve të mirëmbajtjes profilaktike periodike me listë artikujsh dhe çmimet përkatëse që kanë të nevojshme këto autoambulanca për periudhën e garancisë. Këto oferta nuk janë pjesë e çmimit të blerjes së autoambulancave, por shërbejnë për parapërgatitjen e AK me qëllim ruajtjen e kushteve të garancisë.

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar legjislacionit në fuqi si, shërben për t’u garantuar se operatori ekonomik do të kryejë shërbimet profilaktike me qëllim ruajtjen e garancisë.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



## Specifikime Teknike

### A- KËRKESAT PËR STANDARTET E CILËSISË

**Automjeti duhet të jetë** minibus (furgon me dritare), sipas standartit të EN 1789 ose SSH EN 1789:2020+A1:2023, i cili nënkupton një **karroceri të mbyllur**, me **dritare anësore në pjesën e kabinës së pacientit dhe pjesërisht në pjesën e pasme**, për të garantuar **ndriçim dhe siguri** gjatë transportit të pacientit. Nuk kërkohet numër i saktë dritarësh, por struktura duhet të jetë **njëtrajtësisht e integruar**, pra, pa module të pavarura të ndërtuara mbi karroceri të thjeshtë (kontejnerë).

Kjo do të thotë që muret e gabinës së pacientit janë të kompletuara nga fabrika me trashësi dhe veshje. Kabina e shoferit dhe pacientit duhet të jenë **me ndarje të brendshme** (mur ndarës), por brenda një karrocerie të vetme të përbashkët të mjetit të homologuar. Po ashtu sistemet e ngrohje, ftohje, ventilim, bateri e dyfishte, pozicioni i gomës rezerv, janë të predispozuar ose të plotësuar nga prodhuesi.

Minibus (furgon me dritare), është i projektuar dhe ndërtuar me **mure anësore që përfshijnë hapësira të dedikuara për vendosjen e xhamave**. Këto dritare mund të jenë fikse ose të hapshme, dhe janë pjesë e një karrocerie të integruar që lejon ndriçimin natyror dhe, në disa raste, ventilimin pasiv të pjesës së pasme të automjetit. Muret e këtij tipi minibusi kanë struktura mbështetëse shtesë për të kompensuar dobësimin që vjen nga hapjet për dritare, por në tërësi ruajnë **një ndërtim të përshtatshëm për pajisje dhe modifikime të brendshme**, veçanërisht për përdorime si ambulanca, mjete të shërbimit publik apo transport pasagjerësh.

Për këtë arsye, **ambulanca e standardit europian EN 1789 ose SSH EN 1789:2020+A1:2023** ndërtohen vetëm mbi minibus me karroceri të tipit **me dritare**, ku muret janë të konceptuara për **modularitet, funksionalitet dhe siguri sanitare**, ndërsa furgonët për mallra përdoren vetëm për transport logjistik dhe nuk janë të përshtatshëm për transformim në ambulanca të certifikuar. Konfigurimi i kabinës së shoferit duhet të jetë **1+1**, një sedilje për shoferin dhe një sedilje individuale për pasagjerin në të djathtë, të ndara ndërmjet tyre, të pajisura me mbështetje krahu, koke dhe mesi. Midis dy sedileve mund të vendoset frigorifer medicamentesh.

Ambulanca duhet të miratohet për një ekuipazh prej minimumi 5 personash duke përfshirë shoferin plus pacientin në barrlë.

Ambulancë e projektuar dhe e pajisur për transportin paraspitalor dhe ndërspitalor, trajtimin dhe monitorimin e pacientëve gjatë transportit.

- Pajisjet për lëvizjen e pacientëve me ambulancë të plotësojnë standartin SSH EN 1865-1:2010+A1:2015 ose ekuivalent.
- Automjeti të jetë i pajisur me Certifikate Konformiteti / CE ose ekuivalent.
- Veshja e mureve të brendshme (material vetrorëzinë/rezinë) të plotësojë standartin SSH EN 13501-1:2018 (për qëndrueshmërinë ndaj zjarrit dhe flakës) ose ekuivalent.
- Impianti elektrik të plotësojë standartet CE (2014/35/EU) ose ekuivalent dhe të sigurisë së impianteve elektrike sipas normave europiane CE (2014/30/EU) ose ekuivalent.

---

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) [www.obp.al](http://www.obp.al)



- Instalimi i impiantit 220V/240V të jetë konform normave të SSH IEC 60364-7-708:2017 ose ekuivalent.
- Pajisjet mjekësore të plotësojnë standartin CE 93/42 ose ekuivalent.
- Të gjitha pajisjet e tjera të plotësojnë standartin CE ose ekuivalent.
- Prodhuesit e automjeteve, ambulancës dhe pajisjeve duhet të plotësojnë standartet e cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalent.
- Të gjithë automjetet duhet të jenë i njëjti model, tip dhe vit prodhimi.
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve dhe aparaturave në autoambulanca, të bëhet sipas kërkesave të dhëna nga AK, duhet të kryhet nga prodhuesi i autoambulancës ose një operator i autorizuar prej tij dhe i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Sistemet e alarmit(sirenat) të dukshme duhet të jenë të trupëzuara (integruara) në karrocërinë e ambulancës, jo të dalin nga karrocëria e saj, duke përdorur struktura të përforcuara të dedikuara prej materiali si vetrorëzine e tjer.
- Autoambulanca duhet të jenë të pajisura me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- Automjeti duhet të shoqërohet me Deklaratë/Faturë zhdoganimit

## **B- Karakteristikat e automjetit**

### **Viti i prodhimit 2025**

Modeli 2025

Cilindrata jo më pak se 2000cc

Fuqia të paktën 167 kt (Cv) (të paktën 125KW)

Klasa dhe emetimi i gazrave: Euro 6

Norma e CO<sup>2</sup>: Euro 6, sipas kategorisë së automjetit

Sistemi i drejtimit me 4 rrota me një aks aktiv (2x4)

Kambio automatike/manuale

Timoni idraulik

Vendi i drejtuesit: Në të majtë

Motorri turbodiesel me injeksion direkt common rail ose ekuivalente

Versioni: Minibus(furgon me dritare), nuk lejohen kontejnerët/modulet ose ndarjet e gabinës së pacientit të pavarura nga kabina e shoferit.

Shpejtësia nga 0 në 80 km/h në një maksimum prej 30-35 sekondash me ngarkesë të plotë - siç kërkohej nga SSH UNI EN 1789+ A2 2023

Grupimet e dritës: Grupet e dritave të përparme dhe ndriçues për indietron.

Sediljet e gabines së shoferit. Nr. 2 sedilje teke të rregullueshme në lartësi, të ndara, të pajisura me mbështetëse krahu, mbështetëse koke dhe mbështetje mesit.

Dimensioni. Kalim të mesëm

Strukturë stabilizuese e përparme me ekran 10" me integrimin e smartfonëve

Bateri me fuqi të shtuar,

Dinamo me fuqi të shtuar

Gjatësia maksimale 5000-6000 mm

Gjerësia maksimumi 2.050 mm duke përjashtuar pasqyrat

Lartësia maksimumi 2.600 mm duke përfshirë antenat e radios

Kapaciteti deri në 35 quintal(kv)

Gabina e shoferit me dy dyer

## Hapje anësore

**Hapja anësore përmes derës rrëshqitëse me dritare**

## Karakteristikat kryesore të shkallës së derës anësore.

- **Automatik/manuale:** del jashtë kur hapet dera dhe tërhiqet brenda kur dera mbyllet.
- **Përmasat:** zakonisht nga 600 mm deri 1200 mm, në varësi të modelit të automjetit.
- **Materialet:** çelik inox ose alumin i anodizuar, për rezistencë ndaj konsumimit dhe kushteve atmosferike.
- **Kapaciteti mbajtës:** deri në 250 kg, i përshtatshëm për përdorim të shpeshtë.
- **Siguria:** i pajisur me sensorë që ndalojnë hapjen gjatë lëvizjes së automjetit.
- **Montimi:** instalohet në shasinë anësore të automjetit, shpesh me kit universal ose specifik për markën e furgonit
- Rrit **sigurinë dhe ergonominë** e stafit mjekësor gjatë ngjitjes/zbritjes.
- Lehtëson **aksesin për pacientë të moshuar ose me lëvizshmëri të kufizuar.**
- Përputhshmëri me standardet SSH UNI EN 1789+ A2 2023 për ambulancat

## Hapja e pasme

**Dimensionet e derës së dyfishtë të pasme sipas SSH UNI EN 1789+ A2 2023**

**Lartësia e hapjes së derës së pasme:**

- Duhet të lejojë futjen dhe nxjerrjen e barrelës standard minimumi 1,85 m gjatësi me pacientin sipër.

- **Minimumi i kërkuar: 1.250 mm** lartësi e lirë.

#### **Gjerësia e hapjes së derës së pasme:**

- Duhet të mundësojë futjen e barrelës me sistem transportues.
- **Minimumi i kërkuar: 1.200 mm** gjerësi e lirë.

#### **Dyer të dyfishta**

Hapja duhet të jetë **90°** deri në 270° për të mos penguar ngarkimin.

Sistemet e mbylljes duhet të jenë të sigurta, mund të hapen **nga jashtë dhe nga brenda**.

- Sistemi i frenimit me 4 frena disqe, ABS me sistem kundër bllokues i rrotave gjatë frenimit.
- ABS – sistemi kundër bllokues i rrotave gjatë frenimit,
- ASR – sistemi kundër rrëshqitjes këndore të rrotave,
- ESP – sistemi i stabilitetit elektronik,
- AIRBAG
- Hill start assist (Sistemi i nisjes nga vendi në të përpjetë)
- Antenë për frekuenca radio VHF/UHF.
- Krik
- Xhiro makine
- Gomë rezervë
- Dy bateri
- Antena
- Tapeta
- Dy celsa me pult
- Trekendesh (siguri rrugore)

Timon i rregullueshëm

Airbag shoferi dhe pasagjeri

Frenuesi i ndezjes: duhet të sigurohet instalimi i një pajisjeje që pengon ndezjen e motorit kur automjeti është i lidhur me rrjetin e jashtëm. Në rast të dëmtimit të frenuesit të ndezjes, një pajisje manuale, duhet të lejojë ndezjen.

Të ketë sinjal akustik që aktivizohet me vendosjen e indietros.

Bashkimet dhe ngjitjet të jenë të papërshkueshme nga rrjedhjet në të gjithë panelet e automjeteve, të mbyllura me njëri-tjetrin dhe me dyshe-menë

Alarmi vizual dhe akustik për shoferin që aktivizohet çdo herë nëse çdo derë e jashtme nuk mbyllet plotësisht ndërsa automjeti është në lëvizje.

Aksesoret e përfshirë në furnizim e automjetit: Dritaret e përparme elektrike

Pasqyra elektrike dhe me ngrohje

Ngrohës dimëror i ndarjes së gabinës së pacientit me energji 220 V nëpërmjet prizës së jashtme dhe termostetit për të rregulluar temperaturën e brendshme

Mbyllje e centralizuar me telekomandë e pajisur me një sistem elektronik që ju lejon të hiqni çelësin duke e mbajtur motorin e mjetit në punë, duke lejuar mbylljen e dyerve, origjinale të prodhuesit.

Kondicionimi i gabinës së drejtimit (shoferit)

---

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) [www.obp.al](http://www.obp.al)

Rrota rezervë me përmasa të rregullta dhe të barabarta me gomat e tjera dhe pajisje minimale të mirëmbajtjes mekanike. Pajisjet për mirëmbajtjen e automjetit (p.sh. rrota rezervë dhe veglat) nuk duhet të jenë të aksesueshme nga gabina e pacientit

Dritat e mjegullës së përparme dhe të pasme

Kondicionimi i gabinës së pacientit

Kamera me pamje të pjesës së pasme me ekran të pozicionuar në kroskotin e shoferit.

Drita LED, shtesë me krah të rregullueshëm (direkt te dera e djathtë) për plotësimin e kartelës gjatë natës

Kablo për karikimin e automjetit nga një kolonë e jashtme.

Mbajtëse dorezash për kabinën e shoferit në 3 madhësi. Gabina e shoferit e izoluar nga zëri, nga izolues të murit ndarës të gabinës së shoferit dhe pacientit.

Kamera e pasme dhe kamera në gabinën e pacientit e kompletuar me monitor të integruar në kroskotin në kabinën e shoferit.

Radio makine me funksionalitet Bluetooth dhe vivavoçe për telefon celular.

**Garancia 2 vjet për autoambulancën.**

## **II-Përshkrimi i jashtëm i autoambulancës:**

### **a-Ngjyrat e autoambulancës: E bardhë**

Aplikimi në autoambulancë i ngjyrave standarte sipas normativave europiane në fuqi.

Kryqi i esculapit, shenjë ndërkombetare e ndihmës së parë: Vendosija në të dy pjesët anësore, në të dyja dyert e pasme dhe në pjesën e sipërme të gabinës së autoambulancës, me dimensione të përshtatëshme dhe me ngjyrën ndërkombetare.



### **b-Shirit perimetral**

Aplikimi i një shiriti perimetrale fosforeshent autoadesive me ngjyrë portokalli me madhësi 20 cm. Ky shirit vendoset edhe në pjesën e mbrendëshme të dy dyerve të pasme.



### c-Shkrimi ambulanca

Aplikimi mbi kofanon e motorrit,të shkrimit AMBULANCA në të kundërt,me dimensione 6x60 me ngjyrë portokalli fosforeshente

Dizaini i makinës: Të shkruar “Ambulanca” në fillim dhe në fund të trupit të mjetit.

### ç-Shkrime të personalizuar.

Numri i emergjencës në qendër të trupit të makinës 127/112

Shkrime në emër të institucionit të realizuara me karakter dhe ngjyrë sipas institucionit.



### d-Izolimi termo-akustik

Izolimi termoakustik i të gjithë ndarjes sanitare me material të posaçëm të futur midis mureve të karrocerisë. Materiali duhet të jetë me fuqi të lartë thithëse të zërit, të nxehtësisë dhe t'i rezistojë ndryshimeve të temperaturës së lartë. Gjithashtu duhet të jetë vetë-shuarës i zjarrit, jo toksik, rezistent ndaj agentëve kimikë, rezistent ndaj pluhurit dhe nuk i nënshtrohet konsumimit me kalimin e kohës. Izolimi duhet të aplikohet në anët dhe në çatin e mjetit dhe në dyer. Klasa e reagimit ndaj zjarrit I.



### e-Muri ndarës

Ndarja e gabinës së pacientit(pjesës sanitare), duhet të ndahet nga kabina e shoferit me një mur ndarës në vetorezin që mund të lahet. Në murin ndarës duhet të krijohet të paktën një dritare me xhama rrëshqitës mbyllëse/hapëse, e bërë nga materiali në përputhje me kërkesat e rregulloreve aktuale, me një sipërfaqe minimale prej 0,12 m2.



### f-Montimi ose instalimi i pajisjeve

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) [www.obp.al](http://www.obp.al)

Të gjitha pajisjet shtesë dhe pajisjet mjekësore të jenë të fiksuara drejtpërdrejt në trupin e automjetit. Pajisjet kryesore dhe struktura fiksohen në telajon e mjetit nëpërmjet sistemeve lidhëse.



### **g-Mobilimi i brendshëm i tavanit – sistem izolimi / mbylljeje hermetike**

Përveç sistemit të ndriçimit dhe strukturave mbështetëse për mbajtës serum, në zonën e tavanit të gabinës së pacientit, kërkohen gjithashtu tub mbajtës dhe parrakë sigurie në tavan për të garantuar sigurinë e operatorëve gjatë ndërhyrjeve dhe trajtimit të pacientëve.

Duhet të jenë të pranishëm gjithashtu 2 mbajtëse serumesh me kapse sigurie të lëvizshëm dhe të heqshëm.

### **GARANCIA : 2 vjet për autoambulancën (kabinën e pacientit).**

### **III-Organizimi i gabinës së pacientit.**

Autoambulanca duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë që të jetë e përshtatëshme ku të vendosen pajisjet sipas tabelës përkatëse dhe sipas standardit të SSH UNI EN S1789 + A2:2014, me referencë për mjetet e tipit të avancuar, të pajisura me aparatura për trajtim të avancuar dhe monitorim të pacientëve sipas metodave të kujdesit intensiv para-spitalor dhe ndërspitalor.

Mobiljet dhe sipërfaqet e punës duhet të jenë të ndërtuara në mënyrë që të lejojnë vendosjen e çdo pajisjeje në një pozicion të caktuar dhe të sigurt. Pajisjet e domosdoshme për përdorim jashtë automjetit duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme përmes dyerve të përdorimit të zakonshëm. Të gjitha pajisjet dhe aksesoret në murin e ambulancës në gabinën e pacientit duhet të jenë të siguruar, për të mos dëmtuar pacientin dhe personelin gjatë transportit dhe manipulimeve në përputhje me standardin SSH UNI EN 1789+ A2 2023

Në çdo rast, duhet të parashikohen të paktën këto elemente:

- Kontenierë të sipërm të modulueshëm (dollar) në anën e majtë;
- Dollar për bombolat portative të oksigjenit;
- Hapësirë e bollshme për materiale të ndryshme, e vendosur mbi kabinën e shoferit dhe e aksesueshme nga gabina e pacientit.
- Parashikim për bombola me support mbajtës për të lehtësuar ngarkimin dhe pastrimin;

- Sipërfaqe pune me bord të jashtëm perimetral të ngritur për të shmangur rrëshqitjen ose rënien e objekteve.

Muri i anës së majtë duhet të jetë i pajisur me strukturë të përforcuar për fiksimin e pajisjeve elektromjekësore.

#### **a-Karakteristikat teknike të mobiljeve**

Të gjitha mobilet (dollapët, strukturat e brendshme) duhet të jenë të ndërtuara nga material vetrorezine.

#### **b-Vende të posacme:**

Në anën e majtë të autoambulancës të jenë të montuar rafte dhe të ketë vende të posacme me material vetrorezine, rezistent ndaj flakes, të certifikuara nga prodhuesi sipas ISO 9001:2015 *ose ekuivalent*, pajisjet sipas CE *ose ekuivalent* dhe SSH EN 13501-1:2018 *ose ekuivalent* dhe SSH EN SSH UNI EN 1789+ A2 2023 *ose ekuivalent*, të përshtatur për vendosjen e aksesorëve si më poshtë:



1. Set imobilizimi për frakturat e gjymtyrëve (splint 5 masa)
2. Barela lëvizëse me dyshek.
3. Bllokues i kollonës cervikale (qafore 3 masa)
4. Barrelë (traume spinale) për shtyllen kurrizore dhe bllokues koke
5. Sistem nxjerrje dhe imobilizimi spinal (KED, Kendrick Extrication Device)
6. Barrelë mushama
7. Spider (Rip sigurimi)
8. Gërshërë Robin
9. Pompe thithese portative (aspirator), volumi thithes min 1 000 ml, 12 V dhe 220 V
10. Monitordefibrilator për autoambulancat
11. Barela Lugë me bllokuesin të derës
12. Karroca lëvizëse portative
13. Bombul zjarrfikëse (estintor) 2 kg
14. Çanta e emergjencës mjekësore për autoambulanca
15. 2 Bombul oksigjeni 7-10 litra
16. 1 Bombul oksigjeni 2 litra



### **c-Tavani i autoambulancës:**

Të jetë i veshur me material vetrorezine që mund të pastrohet dhe desinfektohet lehtësisht.

Të ketë ndricim maksimal në hapsirën e kabinës së pacientit.

Forma të lejojë futjen e një platforme me qark të dyfishtë për dritën, si gjatë ditës dhe gjatë natës, lehtësisht të inspektueshme, të aspiratorit për ajrim dhe qarkullim të ajrit, të ketë dy mbajtëse serumi të fiksuar në tavan, të ketë dorezë mbajtëse për personelin. Drita suplementare me ndriçim të përqëndruar.



### **ç-Dyshemeja**

Dyshemeja duhet të bëhet me borde të të ngritura në mënyrë që të formohet një vaskë e mbyllur dhe të mos lejojë që lëngjet të depërtojnë në çarjet ose ngjitjet e rezinës. Dyshemeja duhet të bëhet ose në një strukturë të vetme, në një vaskë të papërshkueshme nga uji, e bërë vetëm me një derdhje me material kundër rrëshqitjes, ose në çdo rast me metoda ekuivalente për të krijuar një vaskë të vetme në formë dhe të mbyllur pa cepa të dal midis murit vertikal dhe dyshemesë, nyjeve dhe ndërprerjeve ose bashkimeve të tyre. Dyshemeja gjithashtu duhet të jetë e ngjitur plotësisht rreth perimetrit për të parandaluar depërtimin e lëngjeve dhe lehtësisht të lahet dhe dezinfektohet. Dyshemeja duhet të jetë prej materiali me rezistencë të lartë mekanike, rezistente ndaj zjarrit, rezistente ndaj kalbjes dhe jo rrëshqitëse edhe kur dyshemeja është e lagësht. Nuk duhet të jetë me bashkime dhe nuk duhet të krijojë qëndrim uji në sipërfaqe. Referenca normative është SSH UNI EN 1789+ A2 2023



### **d-Dera anësore**

Dera e djathtë e rrëshqitshme me hapje automatike/mekanike e pajisur me xham termik që hapet nga brenda. Dera duhet të veprojë si një dalje emergjente për barelën. Izolim ndaj ujit dhe pluhurit dhe e pajisur me bravë, pajisje sigurie që mund të hapet si nga brenda ashtu edhe nga jashtë.

Të ketë dy doreza të forta të instaluar në murin anësor dhe të pasëm pranë dyerve, për të lehtësuar ngjitjen e personelit në autoambulancë.

### **e-Shkallë elektrike anësore**

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) [www.obp.al](http://www.obp.al)

## Karakteristikat e shkallës së derës anësore.

- **Automatik/manuale:** del jashtë kur hapet dera dhe tërhiqet brenda kur dera mbyllet.
- **Përmasat:** zakonisht nga 600 mm deri 1200 mm, në varësi të modelit të automjetit.
- **Materialet:** çelik inox ose alumin i anodizuar, për rezistencë ndaj konsumimit dhe kushteve atmosferike.
- **Kapaciteti mbajtës:** deri në 250 kg, i përshtatshëm për përdorim të shpeshtë.
- **Siguria:** i pajisur me sensorë që ndalojnë hapjen gjatë lëvizjes së automjetit.
- **Montimi:** instalohet në shasinë anësore të automjetit, shpesh me kit universal ose specifik për markën e furgonit
- Rrit **sigurinë dhe ergonominë** e stafit mjekësor gjatë ngjitjes/zbritjes.
- Lehtëson **aksesin për pacientë të moshuar ose me lëvizshmëri të kufizuar.**
- Përputhshmëri me standardet SSH UNI EN 1789+ A2 2023 për ambulancat

Dritaret e derës anësore dhe dyerve të pasme me siguresë të brendëshme në mënyrë që të mos hapen nga jashtë. Dritaret të jenë në përputhje me direktivën SSH UNI EN 1789+ A2 2023



## f-Dyert e pasme, sipas SSH UNI EN 1789+ A2 2023

Dy dyer të pasme të jenë me xham dhe opake, termal dhe të temperuara për 3/4 e lartësisë.

Veshja e dyerve të pasme me material të lavashëm. Një nga dy dyert e pasme duhet të jetë e pajisur me një mbajtës kaskash, me mundësinë për të mbajtur të paktën 4.

## Dimensionet e derës së dyfishtë të pasme

### Lartësia e hapjes së derës së pasme:

- Duhet të lejojë futjen dhe nxjerrjen e barrelës standard minimumi 1,85 m gjatësi me pacientin sipër.
- **Minimumi i kërkuar: 1.250 mm** lartësi e lirë.


### Gjerësia e hapjes së derës së pasme:

- Duhet të mundësojë futjen e barrelës me sistem transportues.
- **Minimumi i kërkuar: 1.200 mm** gjerësi e lirë.

## Dyer të dyfishta

Hapja duhet të jetë **90°** deri në **270°** për të mos penguar ngarkimin.

Sistemet e mbylljes duhet të jenë të sigurta dhe të mund të hapen **nga jashtë dhe nga brenda.**



### **g-Strukturë alumini kundër rrëshqitjes**

Veshje e shkallës së pasme dhe anësore të jetë me veshje alumini kundër rrëshqitjes.



### **gj-Fikëset e zjarrit me pluhur**

Dy bombula fikëse zjarri me pluhur të miratuara, një në kabinën e drejtimit, për të mos penguar drejtuesin dhe tjetri në gabinen e pacientit, të dyja të vendosura në një pozicion vertikal me mbështetëse të përshtatshme për ruajtje dhe përdorim të gatshëm. Të paktën një nga dy bombulat e zjarrit duhet të jetë 3 kg.

## **IV-C Pajisjet**

### **a-Paisja e jashtme**

**Sistemet e alarmit** të dukshme të përparme dhe të pasme:

Sistemet e alarmit të dukshme duhet të jenë të trupëzuara në karrocerinë e ambulancës, duke përdorur struktura të përforcuara të dedikuara prej materiali si vetrorezina dhe duhet të përmbajnë në pjesën e përparme këto elementë:



- Fenelinat e urgjencës gjatë ditës (brenda kutive blu)
- Fenelinat e urgjencës së natës (brenda kutive blu)
- Fenelinat e parkimit ose të transportit (brenda kutive blu)
- Sirenat

### **Në pjesën e pasme:**

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) [www.obp.al](http://www.obp.al)



- Fenelinat e urgjencës gjatë ditës (brenda kapelave blu)
- Fenelinat e urgjencës së natës (brenda kapelave blu)
- Fenelinat e parkimit ose të transportit (brenda tapave blu)
- Dritat e pasme të emergjencës
- Dritat e pozicionit
- Dritat e bardha gjatë ngarkimit të barrelës
- Dritat e bardha anësore

#### **b-Sirenat parësore**

Sirena kryesore elektronike me dy tone e miratuar sipas legjislacionit evropian. E mbrojtur nga agjentët atmosferikë dhe e izoluar akustikisht nga pjesa e gabinës së mjetit, në gjendje të dëgjohet qartë nga përdoruesit gjatë shërbimit (fuqia minimale e kërkuar për altoparlantin 100 Ë, i mundësuar nga bateria e karikuar, duhet të sigurojë një nivel subjektiv zëri, të matur mbi mbajtësin e mjetit, 30 metra përpara tij, jo më pak se 90 dB.

#### **c-Sirenat dytësore**

Sirenë elektronike rezervë me dy tone e miratuar sipas legjislacionit evropian. E mbrojtur nga agjentët atmosferikë dhe e izoluar akustikisht nga gabina e drejtimit, e aftë për t'u dëgjuar qartë nga përdoruesit gjatë shërbimit (fuqia minimale e kërkuar për altoparlantin 100 Ë - në përputhje me karakteristikat e Dekretit të Ministrisë së 17 tetorit 1980, i mundësuar nga bateria e karikuar, duhet të japë një matje subjektive të tingullit të automjetit në nivelin 0,3 në aksimetra përballë saj, jo më pak se 90dB.

#### **ç-Sinjalizim shtesë me dritë portokalli**

Dritat paralajmëruese LED me ngyrë portokalli që aktivizohen kur hapen dyert e pasme me automjetin të ndaluar. Mundësia e përjashtimit të tyre me buton të dedikuar.

#### **d-Ndriçimi i zonës së ngarkimit të pasëm dhe fenerët anësor**

Dritat e bardha të ndriçimit që aktivizohen në mënyrë sinkrone me hapjen e dyerve anësore dhe të pasme të pajisura me një buton çaktivizimi i pozicionuar në pjesën e brendshme vertikale, me qëllim për të patur një sistem ndriçimi, i cili mund të aktivizohet nga brenda gabinës dhe gjatë natës mund të ndriçojë vertikalisht zonën e rrugës që lejon kontrollin e numrave të banesave.

### **e-Drita led të hyrjes së pasme**

Instalimi i dritave LED në hyrjen e pasme në gabinën e pacientit (pjesa sanitare), për të lehtësuar hyrjen dhe daljen dhe në pjesët anësore të djathtë dhe të majtë të mjetit për të rritur dukshmërinë e mjetit kur është i parkuar.

### **V-Gabina e shoferit**

Mbështetëse dhe ndarje

Suport për vendosjen e radios fikse transmetuese suport për mbajtje dokumentash që mbyllet.

### **a-Panel kontrolli komande me touch (prekje).**



Paneli standard i kontrollit të shërbimit me prekje, i aplikuar në ndarjen e drejtimit, në një pozicion të aksesueshëm për drejtuesin e mjetit, me ndriçim të pasëm për shikimin e natës. Një dritë paralajmëruese me ngjyra të ndryshme duhet të tregojë nëse komanda është aktivizuar apo jo. Të gjitha funksionet kritike për funksionimin e duhur të mjetit dhe në lidhje me funksionin e mjetit të urgjencës duhet të jenë të kontrollueshme nëpërmjet panelit të kontrollit, duke përfshirë kontrollet e veçanta për dritat ndezëse dhe pajisjet optike, sirenën kryesore dhe sirenën dytësore, dritat dhe fenerët e emergjencës, klimatizimin e kabinës dhe ndarjen sanitare.

Dritat treguese të ndara për të treguar, bateritë, nëse dyert nuk janë mbyllur si duhet në lëvizje, koha, temperatura e brendshme e ndarjes sanitare, temperatura e jashtme, treguesi i kabllit të futur në prizë të jashtme gjatë karikimit të ambulancës kur është e ndaluar.

### **b-Elektrik dore LED**

Fener/pishtar portativ LED i vendosur në ndarjen e drejtimit, i ankoruar fort dhe i lehtë për t'u aksesuar.

### **c-Gabina mjekësore (gabina e pacientit)**

Struktura e përforcimit të ndarjes sanitare

Muret e gabines së pacientit duhet të forcohen për të rritur sigurinë ku mund të ankorohen pjesët përforcuese. Mënyra e forcimit të veshjes së brendshme, të pjesës ndarëse, të mureve anësore të majte, të djathtë, dhe të pasme, të pjesës së rrotave, duke përfshirë çatinë duhet të kryhen me materiale të përputhshme sipas legjislacionit në fuqi.

### **ç-Veshjet e brendshme**

Veshjet e mureve të brendshme me material vetrorezine (fibra xhami), të jenë rezistente ndaj të gjitha substancave për pastrim dhe dezinfektim të cilat janë në bazë kimike ose biologjike – acid dhe rezistente ndaj flakes.

E gjithë hapësira e brendshme të jetë bërë në mënyrë që të gjitha nyjet të mbyllen dhe të veprojnë si një njësi e vetme kompakte. Dizajni i brendshëm të jetë i bardhë ose blu dhe të janë me termo izolim- dhe izolim akustik.



#### **d-Karakteristikat e ndërtimit të gabinës së pacientit (ndarjes sanitare)**

Tavani dhe pjesa e brendshme e mureve të gabinës së pacientit duhet të vishen tërësisht me një monoblok me vetrorezinë të përforcuar. Për të lehtësuar operacionet e larjes dhe pastrimit, duke reduktuar në minimum çarjet dhe boshllëqet.

Ndarja mjekësore e ambulancës duhet të projektohet në atë mënyrë që një ose më shumë njerëz të mund të punojnë rreth pacientit të qetë.

#### **e-Sedilje e pozicionuar në drejtim të kundërt me drejtimin e lëvizjes.**

Sedilja e pozicionuar në drejtim të kundërt me drejtimin e lëvizjes së mjetit, në pjesën e përparme të barelës, e pajisur me mbështetëse shpine të rregullueshme dhe mbështetëse krahësh të palosshme, sedile e ngritshme, e kompletuar me mbështetëse koke dhe rripa sigurie me mbështjellës automatik të integruar në mbështetësen e shpinës. Mbushje anatomike në pjesën e shpinës dhe të sediljes. E ankoruar në dysHEME përmes një shtylle të përforcuar rrotulluese me sistem bllokimi të lëvizjes – sedilja duhet të jetë e veshur me material që lahet kollaj, të papërshkueshëm nga zjarri e klasit I ose vetëizolues të flakes. Ppozicioni dhe lartësia e sediljes duhet të jenë të tilla që të mundësojnë manovrimë mbi një pacient, edhe të intubuar, pa qenë e nevojshme të zhvendoset shtrati – e homologuar në klasën M1 sipas standardit SSH UNI EN 1789 + A2 2014.

#### **f-Sedilje rrotulluese në anën e djathtë**

2 sedilje singole afër, të pajisura me mbështetëse shpine të rregullueshme dhe mbështetëse krahësh të palosëshme, me nritje të sediles, të kompletuara me mbështetëse koke dhe rripa sigurie me mbështjellës automatik të integruar në mbështetësen e shpinës. Mbushje anatomike në pjesën e shpinës dhe në vendin e uljes. Të ankoruara në dysHEME përmes një shtylle të përforcuar rrotulluese, me lëvizje në këto pozicione:

- në drejtim të lëvizjes (përpara),
- në krah të drejtimit të lëvizjes,
- në pozicion 3/4 të drejtimit të lëvizjes.

Të homologuara në kategorinë M1.

### **g-Panel komandimi për gabinën e pacientit me touch (prekje)**

Në brendësi të gabinës së pacientit, duhet të jetë i pranishëm një panel komandimi touch (me prekje) elektronik, i lidhur me centralinën e komandave që gjendet në kabinën e shoferit. Ky panel duhet të jetë i pajisur me ndriçim pasqyrues për lehtësi vizualizimi gjatë natës të shkrimeve dhe ikonave, si dhe ndriçim të butonave.

Funksionet që duhet të ofrohen duhet të jenë ato të nevojshme për kontrollin e të gjitha funksioneve të gabinës së pacientit. P.sh.:

- Ndriçimi i gabinës së pacientit
- Butoni i inverterit
- Statusi i bombolave
- Statusi i baterive
- Sistemi i aspirimit
- Ventilimi
- Sistemi i klimës
- Etj.

### **gj-Pajisje dhe parashikime të mëtejshme të gabinës së pacientit.**

Duhet të parashikohen vendet për:

- Vendosjen e karriges së transportit me suport
- Vend për barelën në formë luge (cucchiaio) dhe barelën spinale, të vendosura në mënyrë që të mund të merren menjëherë.
- Vend për barelën kryesore, e cila duhet të mund të vendoset në qendër të kabinës së pacientit, ose të zhvendoset anash, duke u fiksuar në të dy pozicionet për të kryer manovrat e shpëtimit të jetës sipas nevojës;
- Vend për prozhektor dore dhe Set për hapje emergjente
- Të gjitha pajisjet e domosdoshme për emergjencë duhet të jenë të vendosura dhe të ankoruara në mënyrë të sigurt, me përjashtim të tavanit, për të mundësuar përdorim të shpejtë në raste emergjence.

### **h-Prizë për inkubator transporti**



Duhet të parashikohet një prizë për inkubator transporti me specifikat e mëposhtme:

**110V/120V AC**, 50/60/400 Hz, 270 W maksimal, me **valë sinusoidale ose katrore**, ose

**220V/240V AC**, 50/60/400 Hz, 270 W maksimal, me valë sinusoidale ose katrore, ose

**nga 11 V DC në 13 V DC**, 200 W maksimal, ose **nga 26 V DC në 30 V DC**, 200 W maksimal.

#### **j-Sistemi mbajtës së serumeve**

Pajisjet e mjetit duhet të përfshijnë të paktën dy sisteme mbështetëse për serumet kundër dridhjes dhe lëvizjes gjatë transportit. Duhet të jetë e pajisur me gança për mbajtjen e serumeve për infuzione (të paktën 2 gança). Sistemet e përmendura duhet të kenë kapacitet minimal prej 5 kg. Ato duhet të instalohen në mënyrë që të jenë të lëvizëshme për tu spostuar ose për tu hequr. Sistemi duhet të mundësojë që të varen 2 serume të pavarura nga njëra-tjetra, siç është parashikuar nga SSH UNI EN 1789+ A2 2023.

#### **k-Frigoriferi**

Furnizimi dhe vendosja e një frigoriferi portativ me kapacitet maksimal 7 litra, për t'u instaluar në murin e hapësirës mjekësore ose midis dy sedileve të gabinës së shoferit.

### **VI-Impianti elektrik**

**a-Impiant elektrik** 12 volt, me alternator të zgjeruar dhe ndarje të sistemeve (pjesa mekanike origjinale dhe pjesa e pajisjeve mjekësore). Impianti elektrik duhet të sigurojë ndalimin e korrentit të paisjeve mjekësore në rast avarie, për të mundësuar nisjen e mjetit.

Teknologjia e përdorur për impiantin duhet të jetë e tipit **BUS**. **BUS** është një akronim për *Binary Unit System* (por zakonisht quhet thjesht "BUS") dhe është një rrjet komunikimi **digjital serial** që lidh ndërmjet tyre pajisje të ndryshme elektrike/elektronike përmes një kabulli të vetëm ose një grupi kabujsh të kanalizuar në mënyrë të përshtatshme me kabllo vetë-shuarëse në rast zjarri, jo toksike dhe me seksion të përshtatshëm për të mbështetur furnizimin me energji në mënyrë të sigurt.

Në kontekstin e një ambulance, **teknologjia BUS** përdoret për të menaxhuar në mënyrë **qendrore, të sigurt dhe efikase** të gjitha impiantet elektrike dhe pajisjet.

Disa nga funksionet që menaxhon janë:

- Ndriçimi i brendshëm dhe i jashtëm (dritat sinjalizuese, LED, fenerë, etj.)
- Sirenat dhe sinjalet zanore
- Sistemi i ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar (HVAC)
- Prizat elektrike dhe inverterët
- Bateritë ndihmëse
- Monitorimi i gjendjes së pajisjeve mjekësore

- Alarmer dhe sinjalizime për defekte apo probleme

Të gjitha të realizuara sipas rregulloreve në fuqi. Centralinat ose nyjet(lidhjet) duhet të vendosen në zona lehtësisht për t'u aksesuar; çdo përdorues 220V duhet të jetë i mbrojtur nga një çelës magneto-termik, riaktivizues dhe siguresa për shpëtimin e jetës. Përdorimi i teknologjisë BUS do të lejojë të gjitha teknologjitë që janë të lidhura me të. Sistemi duhet të ndahet në të paktën 4 nyje(lidhje) për të garantuar vazhdimësinë në furnizimin e shërbimeve të ndryshme, edhe në rast defekti të një njësie. Furnizimet e përdoruesve të rëndësishëm, dritat e hapësirës mjekësore, prizat elektrike, llambat e jashtme duhet të ndahen mes dy nyjeve(lidhjeve), për të shmangur që defekti i një nyjeje të ndërpresë plotësisht furnizimin me energji elektrike.

**b-Siguria:** Instalimi i kabllave të impiantit elektrik duhet të realizohet plotësisht brenda mbështjellësve që janë të padëmshëm dhe që janë në përputhje me direktivën CE 2006/95/CE për sigurinë e sistemeve elektrike dhe direktivën CE 2004/108/CE për pajtueshmërinë elektromagnetike dhe të respektojnë normat teknike CEI EN 60335-1, CEI EN 55014, CEI EN 60439-1, CEI EN 50081-1, CEI EN 50082-2.

- Bateri: Bateria kryesore me dimensione minimale 90Ah, e siguruar, me sistem të ndarë për paisjet mjekësore.
- Bateri dytësore/ndihmëse me kapacitet minimal 100Ah, e tipit të siguruar dhe me sistem të ndarë, e pajisur me sistem ndarës karikimi automatik për të izoluar sistemin ndihmës.
- Karikues Bateria: Karikues baterie elektronik me dy dalje që mundëson karikimin e të dy baterive nga rrjeti 220V.
- Rrjeti 220V: Priza për karikim të jashtëm 220V dhe mbrojtje magnetotermike të tipit hermetik, plotësuar me sistem anti-nisje të motorit kur është e vendosur në prizën e rrjetit elektrik 220V.
- Inverter: Një inverter të paktën 1 KË 220 volt, me valë sinusoidale të pastër. Impianti elektrik duhet të përjashtojë inverterin në rast furnizimi me energji karikimi të jashtëm (220V).
- Priza për hapësirën mjekësore të gabinës së pacientit: Katër (4) prisa me tension 12 V dhe 6 A për secilën pranë instalimit të pajisjeve elektro-mjekësore.
- Një prizë 12V 16A e normalizuar CEI për furnizimin e inkubatorit neonatal.
- Tre (3) prisa 220V të instaluar pranë aparaturave dhe pajisjeve të reanimacionit. Prizat duhet të kenë mbrojtje të përshtatshme magneto-termike dhe diferencuese.
- Sistemi duhet të sigurojë pajtueshmërinë elektromagnetike me pajisjet elektro-mjekësore që do të instalohen.
- Sistemi elektrik duhet të jetë i mbrojtur nga një "dispozitiv i shpërndarjes së energjisë në tokë", ose nga një transformator i ndarë. Një raport teknik-shpjegues i sistemit duhet të sigurohet, duke paraqitur zgjedhjet e bëra nga furnizuesi.

## VII-Impianti i ndriçimit

Duhet të realizohet dhe të certifikohet në përputhje me ato që parashikohen për ambulancat sipas SSH UNI EN 1789+ A2 2023. Në dhomën e kujdesit shëndetësor duhet të krijohet një sistem ndriçimi (i përbërë nga disa burime ndriçimi) që garanton një shpërndarje homogjene të ndriçimit të dritës dhe shmang zonat e errëta. Kërkohen drita ndriçimi të shpërndara për natën, me ngjyrë blu.

#### **a-Sistemi i ajrimit dhe klimatizimit**

Sistemi i ajrosjes duhet të ketë tre shpejtësi, si për dalje ashtu edhe për hyrje në gabinën e pacientit. Ai duhet të sigurojë të paktën 20 ndërrime ajri në orë kur mjeti është i ndalur. Duhet të ofrohet një raport teknik ku tregon për vendosjen e sistemit dhe numrin e daljeve të ajrit. Sistemi duhet të realizohet dhe të certifikohet në përputhje me kërkesat për ambulancat UNI EN 1789+ A2 2014. Sistemi i klimatizimit në gabinën e pacientit duhet të sigurojë një mikroklim të përshtatshme për komoditetin e pacientëve dhe operatorëve gjatë të gjithë sezonit, përmes daljeve të ajrosjes. Vendosja e daljeve duhet të jetë e tillë që ajri i ngrohtë dhe i ftohtë të shpërndahet në mënyrë të barabartë në ambient, pa krijuar rryma ose flukse shqetësuese. Vendosja e sistemit të ventilimit duhet të sigurojë qetësinë e sistemit dhe mundësinë e lehtë të aksesit për mirëmbajtje të tij. Duhet të jetë e mundur të përcaktohet temperatura dhe shpejtësia e ventilimit edhe manualisht. I gjithë sistemi duhet të përputhet me SSH UNI EN 1789+ A2 2023. Duhet të ofrohet një raport teknik dhe ilustrues për zgjedhjet e bëra nga furnizuesi.




#### **b-Sistemi i Oksigjenit**

Impianti i gazit mjekësor duhet të ketë tre porta oksigjeni të tipit UNI 9507 me lidhje të shpejtë;

- Sistemi i terapisë me oksigjen duhet të realizohet me tubacione me rezistencë të lartë, të mbrojtura nga goditjet dhe të përputhshme me legjislacionin evropian në fuqi. Ai duhet të ketë të paktën dy fluksometra me lidhje të shpejtë dhe një manometër që tregon presionin e funksionimit të sistemit;
- Duhet të ketë predispozicion për vendosjen e tre bombolave oksigjeni (2+1 rezervë) me kapacitet 7 litra, të kompletuara me reduktor presioni dhe manometër për leximin e presionit. Duhet të ketë një valvul mbylljeje të sistemit dhe mundësi për ndërrimin mes bombolës të zbrazët dhe atij të mbushur; Për të lehtësuar zëvendësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit, bombolat e oksigjenit duhet të jenë të aksesueshme, të pajisur me një derë të mbyllur me çelës sigurie. Në të njëjtën hapësirë duhet të ketë një tub oksigjeni me gjatësi 20m, të kompletuar me rregullator fluksi dhe një portë lidhjeje të shpejtë sipas normës UNI. Duhet të ketë një portë të jashtme për oksigjen. Lidhjet duhet të jenë sipas sistemit femër-mashkull.

- Duhet të ketë mundësi për vendosjen e dy bombolave oksigjeni portative, me kapacitet 2 litra secila, në një zonë të përshtatshme dhe të lehtë për t'u identifikuar. Sistemi i oksigjenit duhet të përputhet me SSH UNI EN 1789+ A2 2023 dhe me Urdhrin 93/42/CEE.



### **c-Sistemi i aspirimit (thithjes) fikse**

Sistemi i aspirimit fiks duhet të jetë i plotë me të gjithë komponentët e nevojshëm për funksionimin e tij të saktë dhe të ketë karakteristikat minimale si vijon: furnizim me korrent 12 V CC, pa zhurmë, i lehtë për t'u pastruar dhe dezinfektuar. Karakteristikat funksionale: mundësia për rregullimin e vakumit nga 0 deri në 500 mmHg; mund të kontrollohet me manometër nga 0 deri në 760 mmHg; thithja maksimale duhet të arrihet brenda 30 sekondash; fluksi në thithje në presionin maksimal duhet të jetë jo më pak se 20 litra/minutë; rezervuari i mbledhjes së sekrecioneve duhet të jetë i pastër dhe njëpërdorimshëm, me kapacitet prej të paktën 500 cc dhe valvul kundër kthimit të likideve. Sistemi duhet të furnizohet me: manometër, rregullator presioni dhe filtrin antibakterial.

### **d-Pajisjet e ndihmës të përfshira në furnizim**

Të gjitha aparaturat dhe pajisjet e nevojshme për një procedurë të caktuar duhet të vendosen në një pozicion të caktuar. Pajisjet e transportueshme për përdorim jashtë mjedisit duhet të jenë lehtësisht të arritshme përmes dyerve që përdoren zakonisht. Të gjitha pajisjet duhet të jenë të ruajtura dhe të siguruara fort, për të parandaluar dëmtimet ose aksidentet kur mjeti është në lëvizje.

#### **1. Barrelë vetëngarkuese me dyshek.**

Barrelë me material polikrom e pajisur me plan në polietilen me dendësi të lartë me bllokues të integruar e cila përdoret për transport pacientësh në autoambulancë. Këmbët e barrelës palosen në mënyrë të pavarur duke aktivizuar komandën përkatëse në fazën e ngjitjes në autoambulancë, ato hapen automatikisht gjatë zbritjes së barrelës nga autoambulanca. Pjesa nga mbështetet koka

dhe trupi i pacientit të jetë e palosshme në grada të ndryshme. Të ketë dy rrota të lëvizshme, me drejtim fiks dhe 2 rrota të lëvizshme, të rrotullueshme për drejtimin e lëvizjes së barrelës. Të ketë frena te rrotat e pasme. Sponde anësor me sistem ulje–ngritje. Ripa sigurie me sistem largimi dhe ngushtimi të integruar dhe të çertifikuar 10G. Dyshek anatomik PVC.

Dimensionet jo më pak se (197cm x 57cm)

Pesha jo më e madhe se 38 kg

Pesha e mbajtjes së barrelës jo më pak se 170 kg

Rrotat me diametër  $\leq 20$  cm

Materiali përbërës metal(çelik) ose inox



### 1.1 Bllokuesit e barrelës të platformës mbajtëse

Bllokuesi i përparmë dhe i pasëm për barrelën e çertifikuar sipas normës EN-1789 (10G), SSH EN 1865-1:2010+A1:2015. E realizuar në një pjesë të vetme në alumin, nylon, polietilen dhe metal (çelik), me komandë bllokimi-zbbllokimi të barrelës në fazën operative.

Dimensionet: jo më pak se (178 x 19) cm

Diametri i profilin të bllokuesve: jo më pak se 2,5 cm


Pesha: jo më shumë se 6.5 kg.

### 1.2 Plani transversal i barrelës (platforma mbajtëse e barrelës)

Të jetë i përshtatshëm për vendosjen, bllokimin dhe sigurinë e barrelës së karikueshme me dyshek gjatë transportit të pacientëve.

Plani i barrelës në alumin i pastrueshëm me dezinfektues dhe me sistem spostimi anësor. Barrela me sistem rrëshqitës ose rregullues për të lehtësuar spostimin e barrelës lëvizëse dhe me hapësirë poshtë saj për të vendosur barrelën e traumës ose barrelën në formë luge me sistem bllokimi. E paisur me struktur rrëshqitëse për imbarkimin e barrelës vetëngarkuese jo më pak se 17 cm.

Në përputhje me standartet SSH EN 1865-1:2010+A1:2015, CE 93/42, SSH UNI EN 1789+ A2 2023



## 2. Karrocë transporti pacienti me mekanizëm rrëshqitës për shkall dhe mbajtës për autoambulancë

Është një karrocë për evakuimin dhe transportin e pacientëve me pamundësi lëvizjeje si pasojë e sëmundjes në rastet e ndërhyrjeve urgjente dhe zona të ngushta, vendet ku mungon anshensori apo nuk mund të aksesohet. Transporton shpejt dhe të sigurt pacientin jo traumatik nga vendi i ndërhyrjes deri në mjetin e ndihmës së shpejtë dhe nga mjeti i ndihmës së shpejtë në urgjencë.

Karakteristikë specifike: Dorezat e pasme, të palosshme dhe të bllokueshme e bëjnë më të shpejtë ngritjen e pacientit. Në pjesën e pasme të karrocës, është i montuar sistemi lëvizës vetërrotullues, me sistem frenimi sigurie të rrotat e pasme që lejon zbritjen e pacientit në shkallë me dy persona, pa e ngritur karrocën peshë. E pajisur me rrip sigurie për lidhjen e pacientit. Ndenjësja dhe mbështetësja e shpinës të jenë të përbëra nga material pvc e lehtë për tu pastruar. Fiksuesi (mbajtësi) i karrocës, montohet në murin e automambulancës. Të jetë i përshtatshëm për llojin e karrocës.

### Përmasat e karrocës:

Lartësia e mbyllur  $\geq 90$  cm /, dorezat e hapura  $\leq 140$  cm

Gjatësia: me dorezat e mbyllura  $\geq 75$  cm /, dorezat e hapura  $\leq 115$  cm

Gjerësia  $\geq 47$  cm

Rrotat e para me diametër:  $\leq 10$  cm.

Rrotat e pasme me diametër  $\geq 15$  cm

Pesha: jo më shumë se 15 kg

Pesha mbajtëse: jo më pak se 170 kg

Materiali: PU, PP, PVC, Alumin, Celik, Nylon



## 3. Bombël me reduktor dhe fluksometer kapacitet 7-10 Litra

Bombël për oksigjen me reduktor të fluksit të O<sub>2</sub> dhe umidifikator. Bombël O<sub>2</sub> e kompletuar me reduktor, fluksimetër dhe umidifikator e destinuar për trajtimin e menjëhershëm të insuficiencës respiratore.

Bombla 7 -10 litër me mbrojtje të integruar të reduktorit dhe fund të gjerë për të rritur stabilitetin.  
Mund të mbajë O2 deri në presion 200 bar.  
Autonomi të lartë kur reduktojmë O2.  
Reduktor me piston me filtër.  
Umidifikator me transparencë të lartë për të garantuar një lexim të thjeshtë të nivelit të O2.  
Rregulluesi i fluksit të O2 nga 0-15 litër /min  
Presioni në dalje të reduktorit 3-4 bar  
Materiali: Celik, polietileni, Alumin, Tunxh i kromuar.

### **3.1 Reduktor oksigjeni**

Reduktor presioni me përlogaritje fikse të përshtatshme për lidhje direkte me bomblën e O2.  
Manometri lejon një lexim të shpejtë të presionit të bombulës në bar. Lidhja e hyrjes sipas standarteve UNI. Valvul sigurie.  
Filtër bronzi i integruar te reduktori.  
Të dhënat teknike  
Dimensionet: jo më pak se (90x130x30) mm  
Pesha: jo më shumë se 0.8 kg  
Presioni në hyrje max 210 bar  
Presioni në dalje max 4.1 bar  
Fluksi në dalje jo më shumë se 145 l/ min  
Materiali: Tunxh i kromuar, Celik, Bronz, Viton (fluorcarbon)

### **3.2 Fluksimetër**

Pajisje për matjen e sasisë së oksigjenit që i jepet pacientit që aplikohet sipas linjave të shpërndarjes së gazeve mjekësore nëpërmjet lidhjes me gazin specifik. Mundësia e lidhjes me një umidifikator.  
Transparenca e kolonës dhe shkallëzimi lejojnë leximin e menjëhershëm të sasisë së gazit që i jepet pacientit. Sistemi i rregullimit të vazhdueshëm lejon dozën e saktë të nxjerrjes së gazit në mënyrë precise.  
Të dhënat teknike  
Dimensionet: jo më pak se (75x 140) mm  
Presioni: jo më shumë se 350 kPa  
Dalja e gazit në fluksometër nga 0-15 litër/min  
Gazi që nxirret: Oksigjeni  
Materiali: PC, Alumin, tunxh  
Pesha jo më shumë se 160 g.

## **4. Bombël me reduktor dhe fluksometer kapacitet 2 Litra**

Bombël për oksigjen e kompletuar me valvol të destinuar për trajtimin e menjëhershëm të insuficencës respiratore.



Karakteristikë specifike e bombulës 2 litroshe me mbrojtje të integruar të reduktorit dhe fund të gjerë për të rritur stabilitetin.

Mund të mbajë O<sub>2</sub> në presion deri në 200 bar.

Autonomi e lartë kur reduktojmë O<sub>2</sub>

Rregulluesi i fluksit vijon nga 0 deri në 15 litra.

Presioni në dalje 0-3 bar

Rregulluesi i fluksit të O<sub>2</sub> nga 0-15 litër/min.

Materiali: Celik, polietileni, Alumin, Tunxh i kromuar.

#### **4.1 Reduktor oksigjeni**

Reduktor presioni me përlogaritje fikse të përshtatshme për lidhje direkte me bomblën e O<sub>2</sub>. Manometri lejon një lexim të shpejtë të presionit të bombulës në bar. Lidhja e hyrjes sipas standarteve UNI. Valvul sigurie.

Filtër bronzi i integruar te reduktori.

Të dhënat teknike

Dimensionet: jo më pak se (90x130x30) mm

Pesha: jo më shumë se 0.8 kg

Presioni në hyrje max 210 bar

Presioni në dalje max 4.1 bar

Fluksi në dalje jo më shumë se 14,5 l/ min

Materiali: Tunxh i kromuar, Celik, Bronz, Viton (fluorcarbon)



#### **4.2 Fluksimetër**

Pajisje për matjen e sasisë së oksigjenit që i jepet pacientit që aplikohet sipas linjave të shpërndarjes së gazeve mjekësore nëpërmjet lidhjes me gazin specifik. Mundësia e lidhjes me një umidifikator.

Transparenca e kolonës dhe shkallëzimi lejojnë leximin e menjëhershëm të sasisë së gazit që i jepet pacientit. Sistemi i rregullimit të vazhdueshëm lejon dozën e saktë të nxjerrjes së gazit në mënyrë precise.

Të dhënat teknike

Dimensionet: jo më pak se (75x 140) mm

Presioni: jo më shumë se 350 kPa  
Dalja e gazit në fluksometër nga 0-15 litër/min  
Gazi që nxirret: Oksigjeni  
Materiali: PC, Alumin, tunxh  
Pesha jo më shumë se 160 g.

#### **5. Monitor defibrilator me mbajtës për autoambulancat**

Monitor-defibrilatori duhet të kryej këto funksione:

a) Monitorim të e aktivitetit kardiak dhe parametrave jetësore si: Elektrokardiograma 3 dhe 10 lidhje, Matje e presionit arterial jo invaziv dhe saturimetris b). Defibrilim manual me piastra manuale, c) Defibrilator gjysëmatomik me piastra autoadezive - AED (Automatic External Defibrillation), d) Pacemaker (me piastra autoadezive)

Monitor me ngjyra TFT-LCD rezistent kundrejt goditjeve dhe dëmtimeve, jo më të vogël se 8 inhc (20 cm) ku të pasqyrohen të gjitha lidhjet e EKG-së, saturimi, pulsi, parametrat vitale, alarm etj.

Diapazoni i shkarkimit te energjisë 1-230J

Kohëzgjatja e baterisë të jetë jo më pak se 3 orë

Impuls bifazik që ndryshon sipas specifikave të pacientit në Automatic Mode

EKG 12 kanale

Pacemaker të jashtëm transtorakal me frekuencë me amplitude maksimale,

30 ppm-250 ppm për impulse 0-150 mA (NIP) me zgjatje deri në 22 sekonda

AED (Automatic External Defibrillation) mode me energji fikse 200J. Me amplitude FV (fibrilacion ventrikular) me e madhe se 150 mikro volt dhe TV (takikardi ventrikulare) me ritëm më të madh se 150 rrahje në minutë.

Pulsoksimetri (saturimi i O<sub>2</sub>) me diapason 0-100%

Aksesor për matje presionit arterial (NIBP) për të rritur dhe për fëmijë

Printer termal të integruar për të printuar EKG-në sipas derivacioneve të zgjedhura.

Rrip mbajtës dhe xhepa anësore të integruar për ruajtje nga demtimet dhe transport të shpejtë të aksesoreve

Memorie për ruajtjen e të dhënave minimum 4 GB dhe të paktën 300 orë të dhëna EKG, me mundësi te rishikimit të eventeve.

Mbrojtje e klasit IPX4 që të jetë në gjendje për të punuar në kushte të vështira atmosferike

Piastra manuale (pediatrike + adulte) të integruara të pajisura me butona karikim /shkarkim energjie

Elektroda ngjitëse(1 përdorim) për defibrilimin gjysëm automatik dhe pacemaker për të rritur dhe fëmijë

Aksesor SPO2 Pulsoksimetri

Të ketë kabell karikimi për defibrilatorin (220 v)

Mbajtës për monitor defibrilatorin që fiksohet në murin e autoambulancës. Të jetë i përshtatshëm për llojin e monitorit.

Pesha  $\leq 7$  kg

Dimensionet  $\leq 40/25/37$  cm



**6. Pompe thithese portative** (aspirator), volumi thithes min 1000 ml, 12 V dhe 220 V.

- Aspirator portativ me përmasa të vogla, i lehtë për t'u përdorur me peshë totale jo më të madhe se 5 kg
- Aspirim me fluks të lartë dhe mundësi rregullimi të aspirimit
- Përdorim me saca njëpërdorim dhe enë mbledhëse me kapacitet 1 litër
- I pajisur me tubat silikoni me filtër antibakterial 99% hidrofobik
- Furnizim me bateri të rinovueshme (me karikues baterie) me autonomi përdorimi të vazhdueshëm jo më pak se 45 minuta



- I pajisur me çantë për transport

**AMBU (adult, pediatric)**



- Të përbëhet nga material shumë rezistent silikoni dhe polisulfonat, që garanton qëndrueshmëri, transparent
- Valvula transparente me lidhës të kthyeshëm

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) [www.obp.al](http://www.obp.al)

- Të ketë rezervuar
- Lidhje vetëbllokuese

## 1. BLOKUES KOKE



**Mbështetësja bazë e kokës për ne imobilizimin e shtylles kurrizore, e bërë nga shkumë me densitet të lartë me veshje kundër ujit. Ai lejon një bllokim të shpejtë dhe të sigurt të kokës së personit të traumatizuar.**

## 2. CANTA E AUTOAMBULANCËS



Çanta e emergjencës për autoambulanca :

- Duhet të jetë multifunksionale.
- Me permasa jo me pak se 60x20 cm.
- Me qepje dhe me ngjitje.
- Me ndarje të brendshme, 5 canta te vogla.
- Të jetë me zinxhirë, që çmontohet në pjesë të ndryshme
- Të ketë xhepa anesore me zinxhire.
- Komode në pjesën e shpinës dhe me rripat me mbushje me sfungjer, të rregullueshëm për gjatësinë e trupit të personelit.
- Në pjesën e brendshme ku vendosen cantat e vogla të ketë velkro për fiksimin e tyre.
- Të jetë e përshtatshme për vendosjen e seteve të ndryshme( infuzioni, mjekimi, intubimi, ventilim, canta e parametrave).
- Të jetë e përbërë nga material shumë rezistent me kapacitet të lartë mbajtës dhe me strisho fosforeshente.

Një cantë e madhe të ketë në përbërje të saj një set cantash të vogla (të përbërë nga 5 canta të vogla)

Çantat e vogla:



Çanta e intubimit



b. Çantë për setin e mjekimit



c. Çantë për setin e ventilimit



d. Çantë për setin e infuzionit



e. Çanta e parametrave jetësorë (për mbajtjen e sfigomanometër, stetoskop, termometër, aparat glicemie, pulsoksimetër)

### 3. IMOBILIZUES BACINI (PELVIK)



- Është disa përdorimeshe në formë rrethore e cila bllokun legenit/perlvisin në mënyrë simetrike. Ajo ndalon hemoragjinë e legenit/perlvisit kur ka fraktura të tij në trauma. Bllokohet nëpërmjet një sistemi me rrip të fortë që kalon nëpërmjet një tokëze/unaze, që lejon përshtatjen e mbylljes me ngjitje me velkro, sipas diametrit të legenit/perlvisit të pacientit.

- Radio transparent për radiologjinë, material i padeforueshëm, mund të dezinfektohet dhe dekontaminohet për shumë përdorime, rripi të jetë i përthyeshëm dhe elastik.
- Të jetë i përshtatshëm për mosha të ndryshme.

#### 4. IMOBILIZUES KOLONE ALUMINI FOTO

Imobilizuesi i luget është i ndarë e ndare ne 2 pjese per transport pacienti

Të jetë e perbere nga material alumini me madhesi te ndryshueshme

Te jete e pajisur me rripat lidhes dhe doreza transporti

Te jete e palosshme per te kursyer hapesiren


Te kete gjatesi te ndryshueshme ne diapazonin 1700-2000 mm

Te kete gjeresi 400-440 mm

Pjese e setit te traumes per imobilizimin e pacientit traumatic ne terren ose transportin nga barela ne shtrat



#### 5. MUSHAMA TELO



- Me doreza mbajtese.
- Transferimi nga barela në shtrat;
- Transporti në barelë.

Materiali i papërshkueshëm nga uji - mund të dezinfektohet shpejt.

Përmasat e vogla e bëjnë atë perfekt për ruajtje në hapësira të vogla.

**Karakteristikat kryesore:**

- Material rezistent ndaj ujit.
- Kapaciteti i ngarkesës: jo me pak se 120 kg.

Përdoret për transporte të pacientit jo traumatik në hapësira të ngushta ose për transferim drejt bareles ose shtratit .

#### 6. QAFORË (Bllokues i kolonës cervikale)



- Të jetë me përmasat jo më pak se 30x30 cm
- Duhet të garantojë gjatë lëvizjes së të dëmtuarit një linearizim sipas aksit anatomik dhe shtrirje të sigurt të vertebrave cervikale .
- Duhet të sigurojë një kontroll të mirë të lëvizjeve aksiale dhe përkuljeve laterale të kolonës
- Struktura themelore të jetë e realizuar me material polietilieni me densitet të ulët, që siguron pastrim të lehtë.
- Të jetë fleksibël për të përmirësuar aplikimin, dhe e ngurtë për të përmirësuar imobilizimin.
- Të ketë një hapje të përparme për të lehtësuar aksesin e trakeotomisë.
- Mund të jetë e përbërë nga një pjesë e vetme ose dy pjesë që lidhen me velkro me ngjitje.
- Fiksimi bëhet me velkro me ngjitje.
- Të jetë në 3 masa

**Perdoret per imobilizimin ekolones cervikale ne cdo raste trauma ose jo ku kemi dyshime demtimi**

## **7. SET IMOBILIZIMI PËR GJYMTYRËT (SPLINT)**



Sistem për imobilizimin e gjymtyrëve në rastet e frakturave të gjymtyrëve të sipërm dhe të poshtëm, te të rriturit dhe fëmijët.

Mbyllja me shirita me ngjitje.

Bordurat të jenë me qepje ose ngjitje që sigurojnë qëndrueshmëri.

Materiali Neopren (familja e gomës), Alumin, i veshur në pjesën e brendshme dhe të jashtme me nylon laminat.

Material shumë rezistent, 100% kundër lëgështirës, i cili është i lehtë për t'u pastruar.

I përbërë nga 5 pjesë:

- a. Për imobilizimin e frakturave të pulsit
- b. Për imobilizimin e parakrahut të të rriturit dhe të gjymtyrëve të poshtëm të fëmijës



- c. Për imobilizimin e kavaljes, bërrylit ose si bllokues krahë gjatë infuzionit venoz
- d. Për imobilizimin e gjymtyrëve të sipërm të të rriturit ose të gjymtyrëve të poshtëm të fëmijëve
- e. Për imobilizimin e gjymtyrëve të poshtëm të të rriturit.

E pajisur me çantë për vendosjen e setit.

## 8. SET IMOBILIZIMI KOLONE



- Të përmbushë kërkesat ergonomike sipas standarteve ndërkombëtare
- Të jetë e përbërë nga materiale të përshtatshme dhe dhe radiotransparent.
- kapaciteti mbajtes jo më pak se 150 kg
- Të jetë e përshtatshme për adultët dhe fëmijët
- Të ketë hapësira anësore për fiksimin e rripave me velkro ose tokëza për imobilizimin e pacientit
- Të vendosen me lehtësi mbajtëset e kokës
- Të ketë rripa me velkro për bllokimin e kokës

**Perdoret ne imobilizimin e nje pacienti traumatik ku kemi dyshime per dëmtim te shtyllës kurrizore**

## 9. SPIDER – SISTEM UNIVERSAL RRIPIASH PËR IMOBILIZIMIN SPINAL



Sistemi universal i rripit merimangë për imobilizimin e shtyllës kurrizore

Të mundësojë një fiksion të shpejtë të të dëmtuarit në barrelë, pa dëmtime të strukturave anatomike,

- Një imobilizim korrekt të kolonës dhe artikulacioneve, edhe në transporte të gjata e në kushte të vështira,
- Rripat e ndërtuar nga material elastik dhe shumë i qëndrueshëm kanë në pjesën fundore të tyre ngjitëse që mundësojnë fiksionin e sigurt në barrelë dhe njëkohësisht mundësojnë shkëputjen e lehtë prej saj, në momentin e heqjes së spiderit.

Eshtë pjese e setit te imobilizimit te nje pascienti traumatik spinal .

Perdoret per matjen e temperatures trupore si nje nga elementet e parametrave jetesor ne vleresimin e pacienti.

## 10.Imobilizues me Vakum (pompa)



### 10. Të gjitha pajisjet dhe aparturat mjekësore të shoqërohen me Deklaratë/Faturë zhdoganimi dhe çmimet për pajisjet, sistemet dhe aparaturat mjekësore

Malli në momentin e dorëzimit duhet të shoqërohet me listë çmimesh të detajuar për: autoambulancën (mjetin), sistemet përbërëse të saj, pajisjet dhe aparaturat mjekësore dhe arredimin/ përshtatjen për autoambulancë.

Gjithashtu automjeti duhet të shoqërohet krahas deklaratës dhe faturës së zhdoganimit edhe me dokumentin e shndërrimit në autoambulancë, si dhe të jetë e pajisur me targa.

**Afati ekzekutimit do të jetë 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës.**

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**